

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Për herë të parë në botë, 67-vjeçares së verbër i rikthet shikimin falë transplantit të retinës – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/per-here-te-pare-ne-bote-67-vjecares-se-verber-i-rikthet-shiki-min-fale-transplantit-te-retines/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 23:33:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	1 shtator 2026, 09:57:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4f177bd3c237ab856716125bddca63c29921680aa54edbff6c1772308d7abae2
TEKSTI	19f41ecd1ab956b2590c69e43ad1318afd2f4bd46b4af63eac2406e58dfd7eba
PAMJA	c92580a5203b1625134fe8bfc8d1462e6c7198df005e11291366d88933f70f4d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	17baef23c6f0ec0da581395e08db66c254b3ad2efcbff21f4ac43de933f12549
E MËPARSHMJA	84e3ccea13f974ee025ad1e937f113de2c01eafc93c007062b3076a34b8309ca
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/17baef23c6f0ec0da581395e08db66c254b3ad2efcbff21f4ac43de933f12549>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Një 67-vjeçare italiane, e cila kishte humbur plotësisht shikimin pas një aksidenti të rëndë automobilistik, ka arritur të shohë sërish falë një ndërhyrjeje novatore të kryer në Torino.

Pacientja, e identifikuar si Elena, kishte pësuar dëmtime të rënda në të dy sytë. Në syrin e majtë, nervi optik ishte dëmtuar dhe nuk mund të transmetonte më sinjale drejt trurit. Për pasojë, edhe pse disa struktura të syrit kishin mbetur të shëndetshme, ai nuk mund të prodhonte shikim funksional.

Ndërkohë, syri i djathtë vuante prej më parë nga degjenerimi makular dhe ishte dëmtuar më tej nga aksidenti. Dëmtimet prekën retinën dhe kornenë, duke e lënë gruan pa shikim funksional për më shumë se pesë vjet.

Mjekët përdorën indet e njërit sy për të rikonstruktuar tjetrin

Në raste të tilla, transplant i kornesë mund të jetë një alternativë, por dëmtimet e Elenës ishin shumë të mëdha për një procedurë të tillë.

Mjekët e Klinikës Universitare të Oftalmologjisë në spitalin Molinette në Torino vendosën të ndiqnin një qasje krejtësisht tjetër: të merrnin indet e shëndetshme, por jo funksionale, nga syri i majtë dhe t'i transferonin në syrin e djathtë, i cili ende kishte lidhje funksionale me trurin.

Operacioni u drejtua nga Dr. Michele Reibaldi dhe zgjati rreth gjashtë orë.

Kirurgët transferuan në syrin e djathtë pjesë të kornesë, sklerës dhe konjunktivës, si dhe, në atë që u cilësua si një rast i parë ndërkombëtar, zonën qendrore të retinës. makulën.

5 Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor:
Një vit të mbarë për nxënësit,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Qëllimi ishte të transferohej indi i shëndetshëm nga syri i majtë, i cili nuk mund të komunikonte më me trurin për shkak të dëmtimit të nervit optik, në syrin e djathtë, i cili ruante këtë aftësi, por kishte pësuar dëmtime të rënda strukturore.

Sipas raportimeve, ndërhyrja rezultoi e suksesshme dhe Elena filloi të rikuperojë gradualisht shikimin në syrin e djathtë.

Dr. Reibaldi e përshkroi operacionin si një “maratonë të ndërlikuar kirurgjikale”, duke e cilësuar atë si një hap të ri në kirurgjinë okulistike.

Sipas mjekëve, deri tani nuk ishte realizuar transplantimi i zonës qendrore të retinës në këtë mënyrë.

Megjithatë, specialistët theksojnë se kjo nuk do të thotë se teknika mund të përdoret menjëherë dhe gjerësisht për të gjithë pacientët që kanë humbur shikimin. Bëhet fjalë për një procedurë jashtëzakonisht komplekse, e përshtatshme vetëm për raste shumë të përzgjedhura.

Rasti i Elenës, megjithatë, konsiderohet një zhvillim i rëndësishëm për kirurgjinë rikonstruktive të syrit dhe mund të hapë rrugë për trajtime të reja të humbjes së rëndë të shikimit në të ardhmen.

/vizionplus.tv

#Itali

#Kirurgji

#Shikimi




Ana Miha

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



BOTA

Sulm me dron ndaj një anijeje ruse në Detin...

Xhuljana Zhuleku

30 minuta më parë



BOTA

Trump i kërkon Zelenskyt të...

Xhuljana Zhuleku

1 orë më parë



BOTA

Tragjedi! Përmbysët anija me pasagjerë,...

Xhuljana Zhuleku

Dje 23:17



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.